

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQËRISË " Clean JON Energy " SH.P.K.**

Sot, me datë 03/08/2022

**Z. Enver Kovaçi**, shtetas Shqiptar, lindur më 09/02/ 1976 në Breg-Lume, Shqiperi, mbajtës I kartes se Id me nr. 034865341 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

**Z. Dilaver Shyti**, shtetas Shqiptar, lindur më 31/03/1969 në Levan, Shqipëri , mbajtës I kartës se ID me nr.034968285 madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar " **Clean JON Energy** Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

#### **NENI 1**

#### **EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "**Clean JON Energy**" Sh.p.k.

#### **NENI 2**

#### **SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën Tirane, Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Ndre Mjeda, ndertesa nr.31, hyrja nr.2, kodë postar 1023.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

#### **NENI 3**

#### **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

#### **NENI 4**

#### **OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

*- Projektim, ndertim, instalim dhe tregtimi i sistemeve te energjise se rinovueshme, parqeve e fermave diellore, parqet e eres nepermjet turbinave dhe i sistemeve hidro elektrike te shfrytëzuara per vete ose per te tjeret Implementimi dhe menaxhimi I projekteve*

*gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) te energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave te tyre ndihmese. Perfshire dhe pa u kushtezuar vetem ne marrjen e te gjithave lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake perfundimtare, instituionet pergjegjese shteterore (qofshin keto organe Qendrore apo Vendore), apo private te cilat mundesojne zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Ndermjetesim me komision per blerjen, shitjen, prodhimin, instalimin e sistemeve te burimeve te energjise se rinovueshme, parqeve e fermave diellore, parqet e eres nepermjet turbinave dhe sistemeve hidro elektrike te 2 shfrytezuara per vete ose per te tjeret. Shitja me shumice dhe pakice e energjise elektrike tek operatoret, furnizuesit, tregtaret, konsumatoret e energjise elektrike (vendas apo te huaj), si dhe ne Bursen Shqiptare te Energjise Elektrike (ALPEX), apo Bursa te tjera te Energjise jashte vendit..*

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 5.000.000 Lek dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z.Enver Kovaçi** zoteron 1 kuotë, me 96% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 4,800,000 Lek dhe 4,800,000 Lek të kapitalit themeltar.
- **Z.Dilaver Shyti** zoteron 1 kuotë, me 4% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 200,000 Lek dhe 200,000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z.Enver Kovaçi**, e cila zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 

#### **NENI 7**

#### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **ORTAKËT THEMELUES**

*Z.Enver Kovaçi*



*Z.Dilaver Shyti*

